

URDHËR
Nr. 228, datë 19.12.2025

**PËR ZGJATJEN E VEPRIMTARISË SË TASK-FORCËS PËR MONITORIMIN,
INSPEKTIMIN DHE MARRJEN E MASAVE, ME QËLLIM RREGULLIMIN E
PASOJAVE QË VIJNË NGA MOSTRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA QË
SHKARKOHEN PRANË OSE NË UJËRA LARËSE NË ZONAT BREGDETARE,
OSE NË BREGUN E LIQENEVE E TË LUMENJVE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 6, të aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”, miratuar me ligjin nr. 5/2024,

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e veprimtarisë së Task-Forcës për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave, me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare, ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, në varësi të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), deri më 1 dhjetor 2026.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Task-Forca për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama